



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:019820

Datë: 19.11.2024

Numri i dokumentit: 06476171

PKR.nr.75/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në trupin gjykues të përbërë nga Kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja Nushe Kuka Mekaj dhe gjyqtarët profesionistë Arben Mustafaj dhe Leon Përlaska, anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtoren profesionale Elzana Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit M.H., për shkak të veprës penale *Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autorizimit* nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.2 të *KPRK-së*, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda me shenjë PP/I.Nr.138/20 e datës 09.12.2022, e plotësuar me datë 24.02.2023, pas shqyrtim të marrëveshjes për pranim të fajësisë, me datë 07.11.2024, bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 18.11.2024, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri *M.H.* i lindur më, në fshatin, Luginë e Preshevës, nga i ati, e ëma, e vajzërisë, me vendbanim në rruga e në Gjilan, ka të kryer Fakultetin Teknologjik, i martuar, pensionist, me nr. personal, shef i Departamentit për Mbrojtje të Mjedisit dhe Ujërave në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Ekziston dyshimi i bazuar mirë se nga fillimi i vitit 2013 deri në fund të vitit 2020, si person zyrtar-shef i Departamentit për Mbrojtje të Mjedisit dhe Ujërave në MMPH-së, nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare në pajtim me nenin 8 të Ligjit për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit nr.04/L-175, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për tjetrin, në atë mënyrë që si udhëheqës i njësisë, nuk i ka ndërmarr veprimet ligjore –ekzekutive, për të ndaluar ndërtimet e vikend-shtëpive dhe objekteve hoteliere në Parkun Kombëtar „Sharri”-vikend zona e Brezovicës edhe pse ishte në dijeni se objektet ishin duke u ndërtuar pa pëlqime mjedisore dhe në afërsi të lumit, kurse disa ndërtime edhe në zonën e dyte të Parkut pasi që inspektorët kishin kryer veprimet inspektuese të ndërtimeve rreth lumit Burimi (“Murzhica”), të cilat ishin duke i ndërtuar në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës Nr.04/L-147 Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit nr.03/L-025, Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.03/L-201, Ligjit për Parkun Kombëtar „Sharri” Nr.04/L-087 dhe Planin Hapësinor për Parkun Kombëtar „Sharri”, kështu që si pasojë e këtij mosveprimi janë ndërtuar: objekti hotelier dhe vikend-shtëpitë e NN „.....”, me pronar G.S.-V.S., objekti hotelier “.....” dhe vikend-shtëpitë me pronar R.H., objekti hotelier “.....” me pronar S.G., vikend-shtëpitë e NN “.....” me pronar F.G., vikend-shtëpitë e të pandehurit B.I., vikend-shtëpitë e NN “.....” me pronar N.K., objektin hotelier „.....”(tani “.....”), me pronar A.I., vikend-shtëpitë e NN “.....”, me pronar T.M., të cilat ndërtime kanë bërë degradimin e papërmirësueshëm të mjedisit dhe rrezikimin e pasurive të mbrojtura natyrore në Parkun Kombëtar „Sharri” zona e Brezovicës.

Me këtë ka kryer veprën penale *Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autorizimit* nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 7, 17, 38, 41, 42, 43 par.1, nënpar.1.1 dhe 1.2 të KPRK-së, si dhe nenit 230 par.20, 360, 364,449 par.1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPPRK-së, të njëjtin e:

G J Y K O N

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj.

Në kuptim të nenit 47 të KPRK-së,

Me pëlqimin e të akuzuarit dënimi i shqiptuar prej *6 muaj burgim*, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 5.000 (pesë mijë) €, të cilën shumë obligohet ta paguaj në afat prej 12 muaj duke filluar nga data 01 deri me datën 05, të çdo muaji vijues, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, një ditë burgim llogaritet me njëzet (20) Euro gjobë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej njëqind (100) €, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Obligohet i akuzuari që në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) €, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

A r s y e t i m

Me datë 09.12.2022, Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur Aktakuzë me shenjën PP/I Nr.138/20, e plotësuar me datë 24.02.2023, kundër të pandehurit B.N. për shkak të nëntë vepra penale *Keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar* nga neni 422 par.1 të KPRK-së, nëntë vepra penale *Marrja e rryshfetit* nga neni 428 par.2 të KPRK-së, nëntë vepra penale *Ushtrim i ndikimit* nga neni 431 par. 1 të KPRK-së dhe *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së, D.R. për shkak të nëntë vepra penale të *Keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar* nga neni 422 par.1 të KPRK-së, vepër penale *Marrja e rryshfetit* nga neni 428 par.2 të KPRK-së, dhe vepër penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së, kundër të pandehurve D.R., H.B. dhe D.M. për shkak të veprës penale *Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autorizimit* nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.2 dhe vepër penale *Marrja e rryshfetit*

nga neni 428 par.3 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kundër të pandehurit S.M. për shkak të veprave penale *Marrja e ryshfetit* nga neni 428 par.2 të KPRK-së, *Ushtrim i ndikimit* nga neni 431 par.1 të KPRK-së, *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së, kundër të pandehurit A.Ç. për të veprave *Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autorizimit* nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së dhe veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së, kundër të pandehurit B.H. për shkak të veprës penale *Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autorizimit* nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.2 dhe *Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autorizimit* nga neni 414 par.1 të KPRK-së, kundër të pandehurit M.H. për shkak të veprës penale *Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autorizimit* nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së, kundër të pandehurit H.A. për shkak të veprës penale *Dhënia e ryshfetit* nga neni 429 par.3 të KPRK-së dhe *Ushtrimi i ndikimit* nga neni 431 par.2 të KPRK-së, kundër të pandehurit S.S. për shkak të veprës penale *Marrja e ryshfetit në ndihmë* nga neni 428 par.2 e lidhur me nenin 33 të KPRK-së, kundër të pandehurit J.K. për shkak të veprës penale *Marrja e ryshfetit në ndihmë* nga neni 428 par.2 e lidhur me nenin 33 të KPRK-së, kundër të pandehurit R.B. për shkak të veprës penale *Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autorizimit* nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nën par.2.2 dhe *Marrja e ryshfetit* nga neni 428 par.2 të KPRK-së.

Me datë 24.02.2023, para se të fillohet me shqyrtim gjyqësor, derisa ishte bartës i lëndës, gjyqtari Murat Hulaj, me kërkesë të mbrojtësit të të pandehurit dhe të pandehurit M.H. dhe me pëlqimin e prokurori të çështjes, u është dhënë mundësia e negocimit për marrëveshje të pranimit të fajësisë, ashtu që marrëveshja është nënshkruar me datë 21.08.2023.

Meqenëse gjyqtari Murat Hulaj, është avancuar në detyrë, si bartëse e lëndës, në krijim të kushteve ligjore, trupi gjykues duke vepruar sipas kësaj aktakuze ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, me datë 04.11.2024, në të cilën seancë ka shqyrtuar dhe marrëveshjen për pranim të fajësisë.

Gjatë shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, gjykata ka dëgjuar të pandehurin, mbrojtësin, prokurorin e shtetit dhe të dëmtuarin dhe ka përcaktuar se e pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë; Pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë, si dhe me dëshmi tjera; dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248, paragrafi 1 të këtij Kodi.

Pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të të pandehurit, gjykata ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore në dispozitën e nenit 230 par.20 të KPPRK-së.

Në këtë rast gjykata ka veçuar procedurën penale, njëkohësisht është caktuar seanca për dënimin, me datë 07.11.2024, në të cilën seancë kanë munguar i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit, mirëpo e kanë njoftuar gjykatën përmes emailit zyrtar, se heqin dorë nga kjo seancë, duke mbetur në tërësi pranë rekomandimit të sanksionit penal si në marrëveshje.

Duke vlerësuar në aspektin juridik, Gjkata gjeti se në veprimet e të pandehurit M.H. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale *Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autorizimit nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së*.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, Gjkata vlerësoj se i pandehuri H., ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe përmes dënimit të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i përcaktuar me nenin 38 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes se veprave penale, rrezikshmërinë shoqërore të këtyre veprave, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e këtyre veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që t'i përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 452 par.1 lidhur me nenin 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 pika 2.9 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJE

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.75/24

Bashkëpunëtore profesionale

Kryetarja e trupit gjykues

Elzana Kastrati

Nushe Kuka Mekaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditë, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Pejë.